



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punijene/Prudato Received/Delivery	22. 02 2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Hr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHACK	762/2021		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr.63/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi, Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, si dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.543/2018 të datës 03.02.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A/02/745/2017 të datës 24.11.2017 të parashtruar nga ankuesja me adresë Rruga "Vëllezërit Gërvalla", Objekti III ¼ Bregu i Diellit të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Flutura Hoxha me adresë rruga "B Royal C15, Hyrja 16, Nr.5 në Prishtinë, kundër Vendimit me Nr. 302-KA-D/2017 të datës 02.11.2017 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 19.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A/02/745/2017 e datës 24.11.2017 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr. 302-KA-D/2017 i datës 02.11.2017 i Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës dhe Vendimi me numër ZDPR/03/01/1532/17 i datës 04.10.2017 i Komisionit të Brendshëm Disiplinor i Policisë së Kosovës.
- III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke i bërë kompensimin e pagesës bruto në vlerën 25% për tre (3) muaj të ndaluar në bazë të Vendimit me Nr. 302-KA-D/2017 të datës 02.11.2017 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës.



IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

V. Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

A r s y e t i m

Ndaj ankueses e punësuar në stafin civil të Policisë së Kosovës me Vendimin me numër ZDPR/03/01/914/17 të datës 22.05.2017 të Komisionit të Brendshëm Disiplinor të Policisë së Kosovës i është shqiptuar masa disiplinore *"Ndalesë në pagë 21% e pagesës mujore bruto për 2 muaj"* për shkak të mosbindjes, duke mos zbatuar, shmang, refuzon të bashkëpunoj apo kompromiton ndonjë urdhër nga autoriteti kompetent sipas Kreut III të nenit 15, nenit 18 dhe nenit 27 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012 për Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore në Policinë e Kosovës. Ankuesja kundër këtij vendimi ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa të Policisë së Kosovës. Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës më datë 20.06.2017 ka nxjerr Vendim me numër 140-KA-D/2017 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e datës 26.05.2017 të ankuesen duke e lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Brendshëm Disiplinor të Policisë së Kosovës.

Kryesuesi i Komisionit të Brendshëm Disiplinor i Policisë së Kosovës më datë 16.08.2017 ka parashtruar kërkesë për hetim plotësues të lëndës disiplinore me numër 227-PK-2017 për rastin e ankueses tek Drejtori i Drejtorisë për Standarde Profesionale. Drejtoria e Standardeve profesionale më datë 05.09.2017 ka dorëzuar Raportin përfundimtar të hetimeve plotësuese për rastin 227-PK-2017.

Komisioni i Brendshëm Disiplinor i Policisë së Kosovës, më datë 04.10.2017 ka nxjerr vendim me të cilin ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore *"Vërejtje me shkrim"* në bazë për shkak të mosbindjes së lehtë të paraparë me nenin 27 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012 për Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore në Policinë e Kosovës.

Ankuesja kundër Vendimit të datës 04.10.2017 të Komisionit të Brendshëm Disiplinor me datë 19.10.2017 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa të Policisë së Kosovës me pretendimin që është çështje e gjykuar pasi që për të njëjtën shkelje disiplinore shqiptohen dy masa. Po ashtu kundër këtij vendimi Toger ka parashtruar ankesë më datë 23.10.2017 në Komisionin për Ankesa të Policisë së Kosovës.

Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës më datë 02.11.2017 ka nxjerr Vendim me numër 302-KA-D/2017 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses dhe duke e aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e Toger duke e ndryshuar Vendimin e Komisionit të Brendshëm Disiplinor nga masa disiplinore *"Vërejtje me shkrim"* në masën disiplinore *"Ndalesë në pagë 25% e pagës mujore bruto për tre (3)*

muaj" duke e lënë në fuqi vendimin e Komisionit të Brendshëm Disiplinor të Policisë së Kosovës.

Ankuesja me pakënaqur me Vendimin me Nr. 302-KA-D/2017 e datës 02.11.2017 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës, brenda afatit ligjor konform nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, më datë 24.11.2017 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 6138/2017 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 17.01.2018 ka nxjerr Vendim A/02/745/2017 me të cilin ka refuzuar ankesën e ankueses duke e lënë në fuqi Vendimin me Nr. 302-KA-D/2017 e datës 02.11.2017 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës. Ankuesja kundër vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 03.02.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.543/2018 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e ankueses duke anuluar Vendimin A/02/745/2017 të datës 17.01.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshill.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:: Ankesën me numër protokolli 6138/2017 të datës 24.11.2017 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 20.11.2017; Kontratën me Nr. 07/1 – 1A/0945; Vendimin me Nr. 302-KA-D/2017 e datës 02.11.2017 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës; shpresën për ekzekutimin e vendimit datës 31.03.2017; Vendimin me Nr. 140-KA-D/2017 e datës 15.06.2017 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës; Vendimin me numër ZDPR/03/01/914/17 i datës 22.05.2017 i Komisionit të Brendshëm Disiplinor; Raporti Plotësues disiplinor për Komisionin e Brendshëm disiplinor nr. 227-PK-2017; Raporti përfundimtar i hetimeve plotësuese për rastin 227-PK-2017 i datës 05.09.2017; Kërkesën për hetim plotësues të lëndës disiplinore me numër 227 PK-2017 e datës 16.08.2017; Kërkesë për hetim nga Komisioni i Brendshëm Disiplinor e datës 16.08.2017; Kërkesë referuar hetimin plotësues nga KBD - ZDPO/02/01/736/17; Përgjigje në kërkesë për mendim ligjore e datës 25.08.2017; Kërkesë për mendim ligjore e datës 22.08.2017; Lënda Hetimor Nr. 227-PK-2017 nga Drejtoria e Standardeve profesionale; Raporti Përfundimtar i hetimeve me rekomandim lidhur me lëndët disiplinore për ankuesen i datës 30.06.2017; Raporti i Përgjithshëm i Hetimeve; Përsëritje e shkeljeve disiplinore për të cilat tani është iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankueses datës 29.03.2017; Shkresën elektronike (e-mailin) e datës 22.03.2017 nga për Shkresën elektronike (e-mailin) e datës 21.03.2017 nga për ankuesen; Shkresën elektronike (e-mailin) e datës 20.03.2017 nga për Shkresën elektronike (e-mailin) e datës 22.03.2017 nga për Shkresën elektronike (e-mailin) e datës 14.03.2017 nga për Shkresën elektronike (e-mailin) e datës

14.03.2017 nga	për	Shkresën elektronike (e-mailin) e
datës 13.03.2017 nga	për	Shkresën elektronike (e-mailin) e
datës 28.03.2017 nga	për	Shkresën elektronike (e-mailin) e
datës 27.03.2017 nga	për	Shkresën elektronike (e-mailin)
e datës 24.03.2017 nga	për	Shkresën elektronike (e-mailin) e
datës 24.03.2017 nga	për	Shkresën elektronike (e-mailin)
e datës 28.03.2017 nga ankuesja për		Shkresën elektronike (e-mailin) e
datës 27.03.2017 nga	për ankueses; Rekomandimin e datës 29.03.2017 për	
transferimin administrativ të ankueses; Njoftimin zyrtar për fillimin e hetimeve të		
brendshme i datës 19.04.2017; Shkresën elektronike (e-mailin) e datës 24.04.2017 nga		
	për dhe	Shkresën elektronike (e-mailin) e
datës 26.05.2017 nga	për	Shkresën elektronike (e-mailin)
e datës 06.05.2017 nga	për	Shkresën elektronike (e-
mailin) e datës 12.06.2017 nga	për	Procesverbali mbi
intervistën e dëshmitarit në lëndën hetimore 227-PK-2017 datës 26.05.2017; Procesverbali		
mbi intervistën e dëshmitarit në lëndën hetimore 227-PK-2017 datës 13.06.2017; Njoftimin		
e datës 25.05.2017 nga	Zgjidhja Teknike KEDS e datës 27.03.2017;	
Procedimi i lëndëve disiplinore në shqyrtim dhe vendimmarrje datës 28.07.2017; Vendimi		
i datës 04.10.2017 i Komisionit të Brendshëm Disiplinor; Procesverbali mbi seancën e		
shqyrtimit të rastit i datës 06.12.2017, 26.09.2017; Ankesën e datës 19.10.2017 nga		
ankuesja; Ankesën e datës 24.10.2017 nga Toger		Formulari i vlerësimit të
punës për ankuesen datë 30.01.2017, 13.05.2016 dhe Përgjigjen në ankesën e datës		
08.12.2017 me numër protokollit 6461/2017; Vendimin A/02/745/2017 të datës 17.01.2018		
të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin		
A.nr.543/2018 të datës 03.02.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për		
Çështje Administrative; Procesverbalin e datës 21.01.2021; Thirrje për shqyrtim kryesor e		
datës 11.12.2020; Përgjigje në padi e datës 08.06.2020; Aktvendimin A.nr.543/18 i datës		
27.02.2020; Përgjigje në kërkesë e datës 28.02.2018.		

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit dhe duke u bazuar në vërejtjet e identifikuara sipas Aktgjykimit A.nr.543/2018 të datës 03.02.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e bazuar, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses të parashtruar në ankesë e cila pretendon që Komisioni i Brendshëm Disiplinor respektivisht Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës për rastin e njëjtë ka shqiptuar dy masa disiplinore dhe kjo çështje është e gjykuar (res judicata), sepse për të njëjtën iniciim të procedurës disiplinore janë shqiptuar dy masa disiplinore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses, ka konstatuar që ndaj ankueses është iniciuar procedurë disiplinore për shkelje të detyrave të punës respektivisht refuzimin për të kryer detyrat e caktuara sipas

vendimit të datës 16.08.2016 lidhur me projektin e "Pastrimit të veturave të PK-së si dhe DDD". Lidhur me këtë inicim të procedurës disiplinore Komisioni Brendshëm Disiplinor i Policisë së Kosovës më datë 22.05.2017 ka nxjerr Vendim me numër ZDPR/03/01/914/17 me të cilin ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore *"Ndalesë në pagë 21% e pagesës mujore bruto për 2 muaj"* për shkak të mosbindjes, duke mos zbatuar, shmang, refuzon të bashkëpunoj apo kompromiton ndonjë urdhër nga autoriteti kompetent sipas Kreut III të nenit 15, nenit 18 dhe nenit 27 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012 për Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore në Policinë e Kosovës, ndërsa për të njëjtën arsye është bërë një hetim plotësues, me ç'rast Komisioni i Brendshëm Disiplinor i Policisë së Kosovës më datë 04.10.2017 ka nxjerr Vendim me numër ZDPR/03/01/1532/17 me të cilin ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore *"vërejtje me shkrim"* mirëpo pas ankesës së ankueses respektivisht Nënkolonel dhe Toger të parashtruar në Komisionin për Ankesave, Komisioni për Ankesa i Policisë së Kosovës në bazë të Vendimit të datës 02.11.2017 ka bërë ndryshimin e masës nga *"Vërejtje me shkrim"* në masën disiplinore *"Ndalesë në pagë 25% e pagës mujore bruto për tre (3) muaj"*.

Bazuar në provat e lëndës Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se masa disiplinore *"Vërejtje me shkrim"* respektivisht *"Ndalesë në pagë 25% e pagës mujore bruto për tre (3) muaj"* ndaj ankueses është shqiptuar për të njëjtën shkelje për të cilën Komisioni Brendshëm Disiplinor i Policisë së Kosovës më datë 22.05.2017 ka nxjerr Vendim me numër ZDPR/03/01/914/17 me të cilin ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore *"Ndalesë në pagë 21% e pagesës mujore bruto për 2 muaj"*, rrjedhimisht asnjë nëpunësi civil nuk mund t'i shqiptohen dy masa disiplinore për të njëjtën shkelje dhe për të cilën është vendosur njëherë, kështu që sipas vlerësimit të Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, rasti i procedurës disiplinore ndaj ankueses është vendosur me Vendimin me numër ZDPR/03/01/914/17 e datës 22.05.2017 të Komisionit të Brendshëm Disiplinor të Policisë së Kosovës, dhe nuk ka pasur bazë juridikë për hetim plotësues për të njëjtin objekt të lëndës, rrjedhimisht Vendimi me numër ZDPR/03/01/1532/17 i datës 04.10.2017 i Komisionit të Brendshëm Disiplinor i Policisë së Kosovës përveç që është nxjerr në kundërshtim të plotë me procedurën ligjore është nxjerr në kundërshtim të plotë edhe me ligjin material në dëm të ankuesit, mbi këtë bazë i njëjti është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative sepse ky ligj ka qenë i aplikueshëm në kohën kur ndaj ankueses kanë filluar procedurat disiplinore.

Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Vendimi me Nr. 302-KA-D/2017 i datës 02.11.2017 i Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës, me rastin e shqyrtimit të ankesave është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, sepse nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike lidhur me rastin e ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton që Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës është i obliguar që të fshij nga dosja e nëpunëses civile


çdo masë disiplinore e cila derivon nga Vendimi me Nr. 302-KA-D/2017 i datës 02.11.2017 i Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës dhe duke i bërë kompensimin e pagesës bruto në vlerën 25% për tre (3) muaj të ndaluar në bazë të Vendimit me Nr. 302-KA-D/2017 të datës 02.11.2017 të Komisionit për Ankesa të Policisë së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, si dhe Aktgjykimin A.nr.543/2018 të datës 03.02.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.63/2021, datë 19/02/2021

Avdyl BEKTESHI


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Përfaqësueses së ankueses Avokat znj.
- Znj Gjqtare e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative;
- Drejtorit të Përgjithshëm në Policinë e Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.